

VENDIM
Nr. 732, datë 16.11.2022

**PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E INSTITUTIT TË SIGURISË
USHQIMORE DHE VETERINARISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, dhe të pikës 1, të nenit 123, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Organizimin dhe funksionimin e Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (në vijim “ISUV”), si institucion qendror, juridik, publik, me seli në Tiranë, në varësi të ministrit përgjegjës për ushqimin dhe veterinarinë.

2. ISUV-i financohet nga buxheti i shtetit, nga të ardhurat dytësore që krijon dhe burime të tjera të ligjshme.

3. ISUV-i është Qendër Kombëtare e Referencës Laboratorike për të gjithë fushën e përgjegjësisë. ISUV-i bashkëpunon me institute, qendra kërkimore-shkencore, ente ndërkombëtare dhe qendra reference.

4. ISUV-i ka si mision të garantojë sigurinë dhe cilësinë e ushqimeve, e ushqimeve për kafshë, mbrojtjen e shëndetit dhe të mirëqenies së kafshëve, mbrojtjen e bimëve dhe produkteve bimore dhe mbrojtjen e shëndetit publik në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet kryerjes së veprimtarive laboratorike dhe vlerësimeve shkencore në këto fusha.

5. ISUV-i e ushtron veprimtarinë në këto fusha përgjegjësie:

- a) kryerjen e analizave të sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe mbrojtjes së bimëve;
- b) kryerjen e aktiviteteve të mjekësisë veterinarë;
- c) kryerjen e vlerësimeve shkencore dhe kërkimeve teknologjike.

II. PËRGJEGJËSITË FUNKSIONALE

Në përputhje me legjislacionin, ISUV-i ka përgjegjësi funksionale të organizojë punën, për:

- a) kryerjen e analizave laboratorike, të kërkuara nga institucionet përgjegjëse të kontrollit të ushqimit, ushqimit për kafshë, mbrojtjes së bimëve, institucionet e tjera dhe subjektet private;
- b) kryerjen e veprimtarisë kërkimore-teknologjike, vlerësimeve shkencore dhe publikimeve;
- c) akreditimin e testeve laboratorike që kryen;
- ç) vlerësimin e laboratorëve për pajisjen me autorizim nga ministri përgjegjës për ushqimin.

III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I INSTITUTIT TË SIGURISË USHQIMORE DHE VETERINARISË

1. ISUV-i organizohet si drejtori e përgjithshme, me juridiksion në të gjithë territorin e vendit.

2. ISUV-i kryen këto detyra:

- a) Në fushën e ushqimit dhe ushqimit për kafshë:
 - i. kontrollin mikrobiologjik, të biotoksinave algale, të nivelit të histaminës dhe fiziko-kimik të ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë;
 - ii. vlerësimin e laboratorëve të autorizuar përpara pajisjes së tyre me autorizim nga ministri përgjegjës për ushqimin;
 - iii. analizën e mbetjeve të produkteve mjekësore veterinarë (PMV), metaleve të rënda dhe produkteve të mbrojtjes së bimëve (PMB) në produktet me origjinë shtazore (përfshirë kafshët e gjalla dhe produktet e tyre) dhe bimore, të prodhuara në vend dhe/ose të importuara, në zbatim të legjislacionit për sigurinë ushqimore;

iv. bashkërendimin e punës dhe ofrimin e mbështetjes, përfshirë metodologjitë bashkëkohore, trajnime dhe shërbime të tjera për veprimtaritë laboratorike, për standardet teknike dhe metodat e analizave që kryejnë laboratorët rajonalë;

v. marrjen pjesë rregullisht në testet e aftësive ndërlaboratorike në nivel ndërkombëtar, për të verifikuar performancën e tij për të prodhuar rezultate të qëndrueshme dhe të besueshme;

vi. organizimin e testeve paralele të mostrave të standardizuara për monitorimin e kualifikimit të laboratorëve të autorizuar të kontrollit.

b) Në fushën e shëndetit të kafshëve:

i. kryerjen e analizave laboratorike, në zbatim të programeve kombëtare të monitorimit dhe survejancës së situatës epidemiologjike të sëmundjeve të kafshëve, shpendëve dhe zookulturave;

ii. kryerjen e analizave laboratorike, në zbatim të programeve kombëtare të monitorimit të diagnostikimit, prognozë-sinjalizimit dhe monitorimin e parazitozave, bakteriozave dhe virozave në kafshë;

iii. kryerjen e analizave laboratorike për vendosjen e diagnozës për sëmundjet infektive të kafshëve;

iv. kualifikimin e specialistëve dhe të teknikëve të laboratorëve veterinarë;

v. bashkërendimin e studimeve kërkimore dhe shkencore, për të zbatuar metoda të reja diagnostike për sëmundjet e kafshëve dhe sigurinë ushqimore;

vi. drejtimin metodologjik të laboratorëve veterinarë;

vii. kryerjen e analizave laboratorike konfirmatore për kampionet, rezultatet e të cilave janë kontestuar, pasi janë nxjerrë nga laboratorët e tjerë veterinarë në vend;

viii. pjesëmarrjen në teste zotësie të organizuara nga laboratorët e referencës së Bashkimit Evropian dhe OIE-së;

ix. vlerësimin e laboratorëve veterinarë, nëse janë të aftë për kryerjen e analizave të miratuara;

x. vlerësimin e dokumentacionit të PMV-ve gjatë procedurës së regjistrimit të tyre.

c) Në fushën e mbrojtjes dhe shëndetit të bimëve:

i. vlerësimin e dokumentacionit të PMB-ve gjatë procedurës së regjistrimit të tyre;

ii. kontrollin cilësor të PMB-ve të regjistruara dhe të hedhura në treg;

iii. vlerësimin e laboratorëve, me qëllim miratimin e tyre si laboratorë të miratuar për kryerjen e analizave të kontrolleve zyrtare;

iv. bashkërendimin e punës dhe dhënien e mbështetjes, përfshirë trajnimet dhe shërbime të tjera për veprimtaritë laboratorike, për standardet teknike dhe mënyrat e analizave që kryejnë laboratorët e miratuar;

v. organizimin e testeve paralele të mostrave të standardizuara dhe marrjen pjesë në to, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, për monitorimin e kualifikimit të laboratorëve të miratuar të kontrollit;

vi. marrjen pjesë rregullisht në testet e aftësive ndërlaboratorike, në nivel ndërkombëtar, për të verifikuar performancën e tij për të prodhuar rezultate të qëndrueshme dhe të besueshme;

vii. organizimin e testeve paralele të mostrave të standardizuara për monitorimin e kualifikimit të laboratorëve të miratuar të kontrollit;

viii. garantimin e përdorimit të një sistemi të brendshëm në përputhje me standardet e kërkuara nga laboratorët e miratuar të kontrollit;

ç) kryen analiza në kuadër të planeve kombëtare të monitorimit;

d) kryen analiza laboratorike, në zbatim të programeve kombëtare të monitorimit dhe survejancës së situatës epidemiologjike të sëmundjeve infektive, zoonozave dhe mbetjeve toksike në bimë;

dh) vlerëson dosjet e produkteve mjekësore veterinarë, produkteve të mbrojtjes së bimëve dhe ambalazhit në procesin e regjistrimit, si dhe jep mendimin teknik për procesin e regjistrimi të tyre.

3. Struktura dhe organika e ISUV-it miratohen me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve në fuqi të legjislacionit për organizimin dhe funksionimin e institucioneve të administratës shtetërore.

4. ISUV-i drejtohet nga drejtori i përgjithshëm, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e tij, përfaqëson ISUV-in në marrëdhënie me të tretët dhe përgjigjet përpara ministrit. Drejtori i përgjithshëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi, por pa u kufizuar, me qëllim sigurimin e drejtimit dhe administrimit efektiv të ISUV-it, kryen detyrat, si më poshtë vijon:

- a) përcakton objektivat vjetorë të ISUV-it në përputhje me objektivat strategjike të ministrisë;
- b) miraton planet e punës afatmesme dhe afatgjata të departamenteve;
- c) lidh kontratat e punës në përputhje me Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë, për nëpunësit/punonjësit, marrëdhëniet e punës të të cilëve rregullohen mbi bazën e këtij legjislacioni;
- ç) nxjerr akte administrative për realizimin e funksioneve të ISUV-it si dhe akte të brendshme për menaxhimin administrativ, financiar, të burimeve njerëzore dhe akte të tjera të brendshme, të detyrueshme për nëpunësit e ISUV-it;
- d) delegon kryerjen e detyrave të përcaktuara për periudhën dhe veprimtarinë që delegohet;
- dh) autorizon publikimin e informacioneve për median, publikun dhe subjekte të tjera;
- e) nxjerr urdhra dhe akte të brendshme në përputhje me kuadrin rregullator dhe për zbatimin e politikave, strategjive, programeve të miratuara;
- ë) çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga legjislacioni në fuqi dhe ministri.

5. Drejtori i përgjithshëm në kryerjen e aktivitetit të tij mbështetet nga një zëvendës drejtor i përgjithshëm. Në mungesë të drejtorit të përgjithshëm, në pamundësi të kryerjes së detyrave prej tij ose me autorizim, zëvendës drejtori drejton aktivitetin e ISUV-it.

6. Ministri, me propozim të drejtorit të përgjithshëm, miraton rregulloren që përcakton organizimin e brendshëm të punës dhe sjelljen e personelit të ISUV-it.

7. ISUV-i ka stemën dhe logon e vet zyrtare. Stema përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet “Republika e Shqipërisë, Ministria... (emri i ministrisë përgjegjëse për ushqimin, veterinarinë dhe mbrojtjen e bimëve), Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.”.

8. Vula ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave, për rregullat e prodhimit, të administrimit, të kontrollit dhe të ruajtjes së vulave zyrtare. Vulat prodhohen, administrohen dhe ruhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

9. Marrëdhëniet e punës së drejtorit të përgjithshëm të ISUV-it dhe nëpunësve të tjerë të tij rregullohen në bazë të dispozitave të legjislacionit për nëpunësin civil. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Pika 8, e vendimit nr. 515, datë 19.7.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për ristrukturimin e instituteve kërkimore-shkencore, në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit”, shfuqizohet.

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku